



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 237, Datë 02.11.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMI I GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË TË DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE NGARKESËS NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2016/1719 TË DATËS 26 SHTATOR 2016 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË AVANCË”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 02.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë,

Konstatoi se:

- OST sh.a me shkresën nr. 7329 Prot., datë 23.10.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar përkatësisht Neni 56 dhe Neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE nr.186 dt. 10/11/2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga OST sh.a., në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.
- Dokumenti vjen nga OST sha në vijim të komunikimit Nr. 3886 prot. datë 25.05.2018 me objekt: “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 188, Datë 20.08.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë të

Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllimin përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatorë. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë”. (Bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

KRYETARI

PETRIT AHMETI